

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	TEORIA E MARRËDHËNIEVE NDËRKOMBËTARE
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	O
Viti i studimeve:	IV
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	8
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Enver Hasani
Detajet kontaktuese:	enver.hasani@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	
	<p>Kjo lëndë është e planifikuar për studentët e nivelit të studimeve themelore në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Ka për qëllim t'u ofrojë studentëve njohuri mbi konceptet teorike që mëtojnë t'i japin shpjegim shkencor marrëdhënieve ndërkombëtare.</p> <p>Kjo lëndë u ofron studentëve njohuri si për paradigmat tradicionale në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, e poashtu edhe debatet aktuale në këtë fushë. Studentët do të njihen gjithashtu edhe me natyrën e ndërtimit të paradigmatve teorike në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare si dhe shfrytëzimin e tyre për t'i kuptuar fenomenet dhe dukuritë që ngërthen kjo disiplinë studimore.</p>
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none"> • T'u mundësojë studentëve të vlerësojnë kontributet dhe mangësitë e ngjarjeve dhe fenomeneve kryesore në marrëdhëniet ndërkombëtare. • T'u mundësojë studentëve të kuptojnë se si Teoritë e Marrëdhënieve Ndërkombëtare janë ndërtuar si një fushë studimi. • T'u mundësojë studentëve kuptimin dhe vlerësimin e debateve në marrëdhëniet ndërkombëtare, si ato metodologjike edhe teorike, që kanë qenë të përshtatshme për formimin e shkencave shoqërore në tërësi. • T'u mundësojë dhe tregojë studentëve se si Teoria e Marrëdhënieve Ndërkombëtare ofron një hartë të rrugëve, ose veglat kryesore – nëpërmjet të cilave shqyrtohen ngjarjet dhe proceset më të mëdha ndërkombëtare.
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Studentët që ndjekin këtë lëndë duhet që:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të kenë një pasqyrë të qartë lidhur me atë se çka janë dhe si ndërtohen qasjet dhe metodat

	<p>teorike në marrdhëniet ndërkombëtare;</p> <p>2. Të dinë se cilat janë qasjet kryesore teorike dhe cilat janë premiset e tyre;</p> <p>3. Të familjarizohen me burimet/materialet dhe figurat më të rëndësishme intelektuale në teorinë e marrëdhënieve ndërkombëtare;</p> <p>4. Të dinë si t'i shfrytëzojnë paradigmat teorike për t'i kuptuar fenomenet shumëdimensionale, dinamike dhe të komplikuar që studion lëmi i marrëdhënieve ndërkombëtare;</p> <p>5. Të jenë në gjendje të analizojnë në mënyrë kritike dhe krahasuese pozicionet e ndryshme teorike në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare.</p>
--	--

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	0.5	10	5
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	3	2	6
Detyra të shtëpisë	10	2	20
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	15	60
Përgaditja përfundimtare për provim	15	2	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	4	2	8
Projektet,prezentimet ,etj	10	2	20
Totali			224

Metodologjia e mësimdhënies:

Metodologjia e mësimdhënies do të bazohet në analizën e thellë të materialeve të përfshira në këtë syllabus apo të përzgjedhura sipas udhëzimit të profesorit. Studentët do të ballafaqohen si me materialet/burimet themelore në këtë fushë e poashtu edhe me çështjet reale/praktike në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Një kujdes i veçantë do i kushtohet ndërlidhjes së qasjeve teorike me problemet reale të politikës ndërkombëtare.

Meqë temat që do përfshihen në çdo javë kanë të bëjnë me një qasje të ndryshme teorike, atëherë debatet do vënë theks të veçantë në vështrime krahasuese në mes

	të teorive të ndryshme të marrëdhënieve ndërkombëtare.
Metodat e vlerësimit:	<p>Do të ketë një provim përfundimtar – pjesa kryesore e vlerësimit – që do të mbulojë materialet e detyrueshme për lexim, si shtesë e asaj që është thënë në ligjërata. Nota do të varet në vlerën prej 60 për qind (%) nga ky provim.</p> <p>Për pjesën tjetër të vlerësimit (40 %), studentët do të kenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ☒ Një apo dy prezantime gojore dhe mbrojtjen e të njëjtave përpara studentëve, për jo më pak se 15 minuta. Prezantimi do të jetë lidhur me një çështje të trajtuar në këtë lëndë apo për një temë që do të përcaktohet në konsultim me profesorin e lëndës; ☒ Shkrimi dhe dorëzimi i një punimi për të njëjtën çështje (të prezantuar gojarisht), apo ndonjë çështje tjetër (e cilat përcaktohet në marrëveshje me profesorin). Për nga aspekti i formës, punimi duhet të ketë jo më pak se 7 dhe jo më shumë se 10 faqe të kompjuterit, double-spaced, formati 12 <i>Times New Roman</i>. <p>Një minimum prej 55 % është i nevojshëm për notë pozitive kaluese. Inkurajohet pjesëmarrja aktive, përmbajtësore dhe e rregullt e studentëve në ligjërata.</p>
Literatura	
Literatura bazë:	Scott Burchill, Andrew Linklater (ed), <i>Teori të Marrëdhënieve Ndërkombëtare</i> (Tiranë: AIIS 2010).
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Scott Burchill (ed), <i>Theories of International Relations</i> (New York: Palgrave, 2005). 2. Paul Viotti and Mark Kauppi, <i>International Relations Theory: Realism, Pluralism, Globalism and Beyond</i> (Boston: Allyn and Bacon, 1997); 3. George Sorensen and Robert Jackson, <i>Introduction to International Relations</i> (Oxford: Oxford University Press, 1999).
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e Parë:	Përmbajtja e lëndës, metoda, organizimi dhe kërkesat e lëndës: [HYRJE]: Diskutim hyrës - Çka është Teoria e Marrëdhënieve Ndërkombëtare? Cilat janë metodat e Teorisë së M.N., dhe nivelet e saj?
Java e Dytë:	Realizmi Çfarë nënkuptohet me anarki? Çfarë do të thotë ky koncept? Cka është realizmi dhe neorealizmi? A është realizmi një teori e luftës apo e paqes, apo e të dyjave?

	<ul style="list-style-type: none"> - Fuqia - Struktura - Niveli analitik i Realizmit - Realizmi strukturalist - Hirearkia, Anarkia, Rendi - Dilema e “të burgosurit” - Institucionet dhe shoqëria ndërkombëtare - Parimet morale dhe politika e jashtme - Keneth Waltz dhe doktrina e unipolaritetit
Java e Tretë:	Liberalizmi dhe Neoliberalizmi <ul style="list-style-type: none"> - politikat e brendshme - Teoria e Paqes Demokratike - Institucionet ndërkombëtare - Lufta, demokracia dhe Paqja - Të drejtat e njeriut, Globalizmi dhe Tregtia e lirë - Liberalizmi dhe shoqëria civile
Java e Katërt:	Shkolla Angleze <ul style="list-style-type: none"> - <i>Veprat kryesore:</i> - Hedley Bull, “Shoqëria anarkike” (1977), - Richard Little, “Balanci i pushtetit në marrëdhëniet ndërkombëtare: metafora, mitet dhe modelet” (2007), dhe autorë të tjerë me ndikim; - Shkolla angleze si alternativë e Realizmit: shoqëria ndërkombëtare dhe shoqëria botërore; - Vlerat shtetërore; fuqitë e mëdha dhe diplomacia; - E drejta ndërkombëtare; dallimet me Realizmin dhe Liberalizmin; - Shoqëria ndërkombëtare: Lufta, fuqitë e mëdha, diplomacia, balanci i fuqisë, njohja e sovraniteteve shtetërore.
Java e Pestë:	Marksizmi Karl Marks (1818-1883) <ul style="list-style-type: none"> - Manifesti Komunist - Klasa, prodhimi dhe marrëdhëniet ndërkombëtare sipas Marksit - Marksizmi si teori e kapitalizmit - Metoda e Marksit: materializmi historik - Marksi dhe Shteti - Teoritë marksiste në M.N.: leninizmi; nacionalizmi dhe imperializmi - Sfidat kryesore të marksizmit: Gjinia/Feminizmi, Globalizimi, Ekologjia
Java e Gjashtë:	Teoria Kritike <ul style="list-style-type: none"> - Ndikimi i Shkollës së Frankfurtit - Autorët kryes: Robert Cox, Theodor Adorno, Jürgen Habermas, Simone de Beauvoir - Politika e njohjes në M.N. - Shteti, Forca shoqërore dhe rendi botëror

Java e Shtatë:	Testi mes-semestral (kolokuium)
Java e Tetë:	Postmodernizmi dhe Poststrukturalizmi Tezat e Michael Foucault, Jacques Derrida mbi postmodernizmin dhe strategjitë tekstuale në M.N. <ul style="list-style-type: none"> - Forca dhe Njohja në M.N. - Shtetet sovraane, dhuna dhe rendi botëror - Dhuna në politikë - Konfigurimi i botës: Kufijtë shtetëror dhe Sovraniteti - Identiteti politik modern dhe Arti i të qeverisurit
Java e Nëntë:	Konstruktivizmi <ul style="list-style-type: none"> - Shpjegimet mbi shoqërinë ndërkombëtare - Kultura, Norma dhe Identiteti - Sfidat e teorisë kritike; konstruktivizmit dhe mosmarrëveshjet rreth tyre - Ndryshimet e botës pas 11 shtatorit 2001
Java e Dhjetë:	Feminizmi <ul style="list-style-type: none"> - Gjinia si kategori empirike - Feminizmi empirik dhe roli i grave në M.N. - Feminizmi analitik dhe raporti mashkull-femër në politikën botërore - Roli centralist i shtetit në feminizëm - Feminizmi normativ: agjenda normative për ndryshimet politike - Identiteti feminist dhe solidariteti
Java e Njëmbëdhjetë:	Politika e Gjelbër <ul style="list-style-type: none"> - Ekologjia, mbetjet nukleare, mbetjet industriale - Ekocentrizmi - Trajtimi i krizës globale të mjedisit - Kendvështrimi i feminizmit rreth ngrohjes globale - Politikat e mjedisit dhe ekologjia globale - Gjelbërimi i politikës botërore: dilemat politike -
Java e Dymbëdhjetë:	Burimet e Konfliktit dhe të Bashkëpunimit në Marrëdhëniet Ndërkombëtare <ul style="list-style-type: none"> - Lufta dhe Paqja - Modeli i ndërvarësisë në M.N: nga koncepti Westphalian deri tek Pranvera Arabe - Modelet shtetërore në shek. 21: Siguria, Terrorizmi, Hegjemonia.
Java e Trembëdhjetë:	Përgatitje për provimin përfundimtar.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Cakto politikat e mirësjelljes konform statusit të UP-së.

SHTOJCA I: TEMA TË MUNDSHME PËR ESE DHE/OSE PUNIM AKADEMIK NË LËNDËN TEORIA E MARRËDHËNIEVE NDERKOMBËTARE:

1. Definoni “luftën”, pastaj emëroni/përmendni dy situata aktuale ndërkombëtare që përshtasin në mënyrë të qartë përkufizimin e luftës dhe dy të tjera që janë ambiguoze ose të paqarta (kuaziluftërat).
2. Cila mendoni se janë më serioze, luftërat apo kuazi-luftërat? A përfshijnë ato llojet e ndryshme të aktorëve? Apo lloje të ndryshme të konflikteve? Diskuto!
3. Diskutoni diplomacinë dhe sanksionet ekonomike si dy mjete të politikës së jashtme. Elaboroni eseun tuaj me dy shembuj për secilin rast?
4. Çfarë e përbën qe një shtet te jetë shtet për qëllimet e Marrëdhënieve Ndërkombëtare?
5. Nëse sovraniteti është 'hipokrizi e organizuar', çfarë ndryshimi ndodh me teoretizimin e politikës ndërkombëtare sot në botë?
6. A jemi futur në një botë, e cila mund të quhet bota ‘post-sovranitet’ ku ndërvarësia dhe globalizimi i tejkalojnë kufijtë e sovranitetit?
7. Sqaroni dilemën themelore që mbretëron në mesin e teoricienëve të MN? MN shihen sot më tepër si disiplinë shkencore apo si një realitet politik?
8. Paqja e Westphalisë (1648), mendohet se krijoi shtetet moderne evropiane, në kuptimin politiko-territorial. A ishte ky fillimi i sistemit të marrëdhënieve ndërkombëtare, të bazuar në shtetin?
9. Pas ngjarjeve të 11 shtatorit 2001, politika e jashtme e çdo shteti paraqitet themeli i funksionimit të saj? Cilat janë vlerat kryesore që një shtet i mbron nëpërmjet kësaj politike që paraqitet si faktor kyç në MN?
10. Cilat janë anët pozitive dhe anët negative të “pranverës arabe”?

Vërejtje:

Eseu ose punimi akademik duhet të përmbajë 2.000-2.500 fjalë dhe duhet të dorëzohet më së voni deri më datë (***data caktohet ne marreveshje me mesimdhenesin***) në formë fizike apo alternativisht në adresat elektronike. Pas kësaj date, punimi nuk do të konsiderohet. Punimi pas evaluimit do të vlerësohet nga 0 deri 40 përqind – varësisht nga cilësia, përmbajtja dhe strukturimi akademik.

SHTOJCA II: RREGULLA – UDHËZIME TË PËRGJITHSHME SHKRIMI

Këtu janë disa sugjerime rreth shkrimit të punimeve. Ju lutemi lexojini këto përpara se të shkruani punimin, nëse e keni zgjedhur opsionin e shkrimit të një punimi.

1. **Bëjeni të qartë tezën kryesore të punimit tuaj** në fillim të punimit ose në pjesën hyrëse, e preferuar në paragrafin e parë;
2. **Qëndroni të përqendruar (*konsistent*)** – ajo që paraqitet në fillim të punimit duhet të ketë lidhmëni me gjetjet e paraqitura në fund të punimit.
3. **Shmangini përgjithësimet;**
4. **Shkruani qartë**, duke shmangur fjalitë dhe paragrafët e gjatë;
5. **Mbështetini pohimet apo deklaratimet tuaja** me referenca përkatëse;
6. Pas përfundimit të punimit, **ri-lexojeni dhe redaktujeni atë;**

7. **Mos bëni plagjiaturë.** Plagjiatura shprehet në dy forma, të dyja të palejueshme. *Së pari*, plagjiaturë bëni nëse i përdorni fjalët e një burimi pa e futur atë në thonjëza. Nëse përdorni fjalë nga një burim, atëherë duhet ta vendosni në thonjëza, dhe jo vetëm ta citoni në fusnotë. *Së dyti*, plagjiaturë bëni edhe nëse e merrni idenë ose idetë nga një burim, pa e cituar burimin në fusnotë. *Sanksionimi për plagjiaturë* varet nga shkalla e plagjiaturës, dhe mund të konsistojë nga një notë më e ulët deri te mohimi i të drejtës për ta kaluar provimin në afatin përkatës.